



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e Raportimit Janar- Dhjetor 2016

Në zbatim nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, të ndryshuar Udhëzimit Nr. 1, datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, ushtron aktivitetin buxhetor në Programin buxhetor “Shërbime të tjera”.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me objektivat e STKKU-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve sipas programimit të bërë për vitin 2016.

Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2016 për STKKU-në në total janë 38 400,000 lekë prej të cilave 32,400,000 lekë janë shpenzimet korente dhe 6,000,000 lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për vitin 2016.

Pasqyra 1. Shpenzimet Korente për vitin 2016

KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KESHILLIT KOMBËTAR TË UJIT


Pasqyra Nr.1

SHPENZIMET KORENTE JANAR - 31 DHJETOR 2016

Entiteti Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi I Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor 2016 I rishikuar	Shpenzimet Faktike Janar-Shtator 2016	Diferenca	% realizimit
1	2	3	4	5	6	7	8		12	13
001	87	1087016	01	01150	6000000	3535	21,300,000	20,128,129	1,171,871	94
001	87	1087016	01	01150	6010000	3535	3,400,000	3,230,124	169,876	95
001	87	1087016	01	01150	6020000	3535	7,700,000	2,930,095	4,769,905	38
TOTALI							32,400,000	26,288,348	6,111,880	81

Grafiku më poshtë paraqet shpenzimet faktike të programit sipas artikujve.

Grafiku 1 Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve



Referuar pasqyrës nr. 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për 12- mujorin e vitit 2016 është në masën 81 %.

Më poshtë janë analizuar faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim:

Mosrealizimi vërehet kryesisht në zërin Shpenzime Operative ku buxheti vjetor ishte 11,000 mijë ndërsa buxheti i rishikuar 7,700 mijë lekë nga të cilat gjatë vitit 2016 janë shpenzuar 2,930 mijë lekë ose 38% e vlerës totale të buxhetit. Ky realizim i ulët vjen si pasojë e faktit të kufizimeve për përdorimin e fondeve për trajnime, dieta dhe konferenca të cilat zënë një masë të konsiderueshme të buxhetit të vënë në dispozicion për vitin 2016, pasi një pjesë e personelit ka përfutur trajnime apo pjesëmarrje në aktivitete të cilat janë financuar nga donatorët e ndryshëm.

Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqerore (zërat 600 dhe 601) janë realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Urdhër nr.datë 2014.

Realizimi për periudhën 12 mujore për artikullin 600 dhe artikullin 601 janë respektivisht nga 94% dhe 95% e vlerës totale të buxhetit për arsyen se struktura organizative është plotësuar 91%, numri faktik është 21 punonjës nga 23 që janë në organikë.

Tabela 2. Shpenzime Kapitale


Në lekë

**SHPENZIMET FAKTIKE NE NIVEL ARTIKULLI
PER PERIUDHEN 01.01.2016 -31.12.2016**

Entiteti i Qeveris e	Minis tria e Linje s	Kodi Instituc ionit	Kapi tulli	Prog rami	Logaria Ekonomik e	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor	Shpenzimet Faktike12 Mujori 2016	Diferenca (11-10)	% realizimit (11/10*100)
							I Ndryshuar			
1	2	3	4	5	6	7	8	12	13	
							6,000,000	5,558,834	97,858	93
001	87	1087016	01	01150	231	3,535	868,884	771,034	97,850	100
001	87	1087016	01	01150	231	3,535	756,108	412,800	343,308	100
001	87	1087016	02	01150	231	3,535	235,008	235,000	8	100
001	87	1087016	02	01150	231	3,535	4,140,000	4,140,000	-	100
							6,000,000	5,558,834	441,166	

Grafiku 2 paraqet realizimin e fondit të investimeve.

Grafiku 2 Realizimi i investimeve për vitin 2016



Referuar tabelës nr. 2 realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për vitin 2016, është në masën 93% e fondit të përdorur, ndërsa si projekte realizimi është në masën 100%.

Projekti me kod M 870074 “Blerje automjeti” është realizuar 100%

Projekti me kod M 870014 “Paisje elektronike workstation”, është realizuar 100%

Projekti me kod M 870160 “**Softe profesionale**”, është realizuar 100%.

Po kështu si rezultat i rishikimit të fondit të investimeve, për nevoja të punës si rezultat i akomodimit në zyrat e reja, u rialokua fondi për blerje paisje kondicionere, projekt i cili u realizua në masën 100%.

Nga fondi total u kursyen 441 mijë lekë.

Objektivat për vitin 2016


1. Ndërtimi i një sistemi total të integruar për drejtimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve ujore;
2. Ndërtimi i një sistemi të integruar të informacionit në fushën e ujit;
3. Mirëmanaxhimi kombëtar i burimeve ujore;
4. Mirëadministrimi dhe mbrojtja e ujrave ndërkufitare;
5. Optimizimi i vendimarrjeve të KKU-së për përdorimin e burimeve ujore;
6. Mirëfunksionimi i Këshillave të Baseneve Ujore, Përcaktimi i zonave të ruajtjes bazuar në Ligjin 111/2012;
7. Njohja e plotë e institucioneve qendrore me problematiken e dhënies së autorizimeve për veprimtarinë ndërtimore në brigje;
8. Projektion dhe modelon sistemin e integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore, financiare dhe aseteve si pjesë e sistemit total të integruar të qeverisjes dhe menaxhimit të burimeve ujore.

Realizimi i objektivave nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2016.

Në funksion të realizimit të objektivave janë kryer aktivitetet dhe janë realizuar produktet si më poshtë vijon:

Në mënyrë grafike realizimi i produkteve paraqitet në grafikun 3.

Grafiku 3 Realizimi i produkteve në përqindje



Produkti A: Hartimi i Dokumentit të Planifikimit Sektorial për përfitim të mbështetjes financiare nga Bashkimi Europian në sektorin e ujit për 2017, është realizuar 100 %. Është përfunduar faza e parë e përgatitjes së SPD në bashkëpunim me ministrinë e linjës. Janë reflektuar në tre periudha të ndryshme komentet e bëra nga delegacioni europian.

Produkti B: Hartimi, implementimi dhe monitorimi i Programit Kombëtar Sektorial, ka përfunduar rreth 90% e produktit. Është përgatitur drafti i parë i PKS i cili është duke u diskutuar me nëngrupet tematike, për tu plotësuar me të dhëna dhe reflektuar komente të ndryshme.

Produkti C: Ndjekja e mbledhjeve të Nëngrupeve Tematike është realizuar në masën 125%, Janë organizuar 10 mbledhje për secilin nga 4 nëngrupet tematike, pra gjithsej 40 mbledhje.

Produkti D: Organizimi i mbledhjeve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Sektorin e ujit (GMIP), është realizuar në masën 15% , ku nga 2 mbledhje që janë parashikuar, nuk u realizua asnjë pasi drafti është ende në proces. Megjithatë problematikat e sektorëve të ndryshëm janë prezantuar gjatë mbledhjeve të KKU-së.

Produkti E: Ndjekja e Kadasrës Kombëtare të burimeve Ujore dhe hartimi i inventarit të burimeve ujore është realizuar 85%. STKKU ka ndjekur vazhdimisht procesin e hartimit të kadasrës duke dhënë kontribut në përmirësimin në bashkëpunim edhe me MBZHRAU me synim përfundimin e projektit sipas detyrimeve.

Produkti F: **Hartimin dhe monitorimi i standardeve, rregullave dhe përputhshmërinë e informacionit në bashkëpunim me ASIG dhe institucionet e tjera qëndrore dhe vendore,** është realizuar në masën 100%. Është bashkëpunuar me ASIG për hartimin e standardeve për sektorin e ujit si dhe me institucione të tjera.

Produkti G: **Ndjekja, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.** Për realizimin e këtij produkti është punuar në masën 90 % e tij në raport me planin vjetor. Prezantimi me komentet e reflektuara për draftin e konsoliduar të strategjisë, është dorëzuar në muajin korrik.

Produkti H: **Ndjekja e hartimit të "Planeve të menaxhimit të baseneve", dhe miratimi i tyre.** Është realizuar rreth 50% e produktit, është në proces takimesh me konsulentin për hartimin e draft strategjisë Drin-Buna dhe Seman.

Produkti I: **Ndjekja e marrëdhënieve me vendet fqinje për administrimin e ujërave ndërkufitare.** Është realizuar në masën 55% e totalit, ku nga 7 takime të planizuara, janë realizuar vetëm 4. Janë realizuar pjesëmarrjet në mbledhjet e KPAUN, workshopet e ndryshme me këtë fokus si dhe pritja e informacionit nga institucionet respektive të dokumentacionit ligjor që disponojnë në lidhje me marrëdhëniet ndërkufitare.

Produkti J: **Organizimi i mbledhjeve të KKU-së dhe zbatimi i detyrave të lëna nga ky organ**

Janë realizuar 2 mbledhje të KKU nga 4 të mbledhjeve të planizuara për vitin 2016. Është në proces përgatitje të materialit përfundimtar.

Produkti K: **Kontrolli i veprimtarisë të organeve vendore të Menaxhimit të Burimeve Ujore.**

Nga 18 kontrole janë realizuar 7 prej tyre përfshirë këtu takimet në mbledhjet e KBU-ve për konstituimin e Këshillave të Baseneve në të gjashtë basenet respektive, kontrole në veprat hidrike në basenet Shkumbin dhe Ishëm-Erzen.

Produkti L: **Hartimi i draft VKM për zonat e vecanta viti 2017**

Janë parashikuar 2 takime për vitin 2016 dhe aktualisht nuk është realizuar asnjë, pasi procesi është në fazën e korespondencës me AKZM për hartimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura si pjesë përbërëse e planeve të menaxhimit të baseneve, takim me konsulentin që po harton Planet e Menaxhimit Drin-Bunë dhe Seman për njohjen me problematikën përkatëse.

Produkti N: **Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve financiare,** është realizuar në masën 70%. Janë kryer takimet e radhës me ministritë e linjës dhe institucionet e tjera. Është siguruar informacion nga donatorët që kanë investuar në fushën e ujit dhe përgatitja e drafteve të buxhetimit të integruar të sektorit.

Produkti O: **Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore** është realizuar rreth 70% e produktit. Janë organizuar takime me institucione që lidhen drejtpërdrejtë me burimet njerëzore të sektorit të ujit, si trajnime nga DAP dhe nga organizata të tjera.

Produkti P: **Blerja e paisjeve për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e objektivave në STKKU.** Relazimi i këtij produkti është në masën 100% e totalit. Është realizuar blerja e automjetit të institucionit, paisjet elektronike, programi informatik, vënia në punë e të cilave

përmirëson ndjeshëm cilësinë e punës në institucion dhe realizimin e objektivave për të ardhmen.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI KOMBËTAR I UJIT

HANTIN BONATI

